



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË  
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr 3618 Prot

Gjirokastër më 10 : 10.2023

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 05.10 .2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 05.10. 2023

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në **05.10.2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e hotel “Çajupit”. Mbledhja fillon në orën 12:10  
Marrin pjesë në mbledhje 18 anëtarë dhe vjen 5 min me vonesë Z. Dashamir Qeli .Gjithsej 19 anëtarë.

Mungojnë në mbledhje; Rova, Llogo, Lapa, Feruni, Leskaj, Guçe, Nurçe, Koçollari, Çuçani, Cacaj, Aliko, Peta.

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës së bashku me pikat shtesë të propozuar nga ekzekutivi:

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.08.2023.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-30.09. 2023**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-30.09. 2023**”.
4. P/Vendim “Për vendosjen në Shtëpinë e të Moshuarve “Shpresa e Jetës””.
5. “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023” me qëllim implementimin e projektit me financim të “Askush të mos mbetet pas - programi i perbashket i OKB-se (LNB2) dhe financimin e kostove lokale për Roma on market dhe Romacted.
6. P/ Vendim “ Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z. Agim Idajet Shehu( pas vdekjes)
7. P/ Vendim “ Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z. Luis Mitat Çene ( pas vdekjes)
8. P/ Vendim “ Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z. Petro Çerkezi
9. P/ Vendim “ Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z.Agron Asaf Galanxhi ( pas vdekjes)
10. Raport i punës së Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare për periudhën Janar – Gusht 2023.
11. P/Vendim “ Për miratimin e rregullores së funksionimit të Institucioneve të APSH”
12. Të ndryshme.

Dy pikat shtesë janë:

1.P/Vendim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për z. Banush Mezini.

2.P/Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023” me qëllim financimin e projektit Hidroizilim dhe riparim ulluqesh ,gjimnazi “ Siri Shaplo”, Gjirokastër”.

Z. Brahimi:Sygjeron që për një mbledhje tjetër të mendohet mirë edhe për emra të tjerë të ndritur të gjimnazit “ Asim Zeneli”, SI Petro Isufi, Vojo Kuka . Të organizohet një mbledhje jashtë radhe për këtë gjë dhe të kemi kohë për t ’i vlerësuar.

Për z. Galanxhi , ai ka dhënë jetën për këtë vend dhe nuk diskutohet dhënia e titullit.

Mund të shtojmë edhe emra të tjerë që duhen vlerësuar. Mendoj të ngrihet një grup pune me bashkinë dhe ZVA-në.

Z. Adrian Novi: Ka edhe emra të tjerë, pse të japim tituj pas vdekjes, kur mund t’i japim edhe tani që janë dhe punojnë ende.Të merret lista e tyre dhe të kalohen në komisione.

Z. Drasa: Jam dakord me këtë propozim te Petritit dhe të bëhet mbledhja sa më shpejt të jetë e mundur.

Miratohet rendi i ditës së bashku me pikat shtesë me 19 vota pro.

Miratohet me 19 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 31.08.2023

Hidhen në votë dhe miratohen pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës dhe miratohen me 19 vota pro.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-30.09. 2023**”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-30. 09.2023**”.

Hidhen në votë dhe miratohen me 19 vota pro dy vendosjet për në shtëpinë e të moshuarve për z. Hodo Këndella dhe për znj. Eleni Dhoska.

Kalohet në pikën 5 të rendit të ditës. “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023” me qëllim implementimin e projektit me financim të “Askush të mos mbetet pas - programi i perbashket i OKB-se (LNB2) dhe financimin e kostove lokale për Roma on market dhe Romacted.

Sqaron për këshilltarët Drejtoresha e Financës znj.Artiste Koko.

Këto 2 projekte janë miratuar në 2022 dhe një projekt është i ri , I cili ka të bëjë me shërbimet sociale që mbështet bashkia jonë. Titulli I projektit të ri është “ Askush të mos mbetet pas”

Kostot e bashkisë janë 4milion e 246 mijë për dy projektet e para, kurse për projektin e ri nuk ka kosto në fazën e parë.Kostot janë të parashikuara në buxhet.

Hidhet në votë dhe miratohet me 18 vota pro dhe 1 kundër, Z. Drasa pika 5.

Znj. Isaraj hedh në votë P/Vendimet për titujt e nderit.

Miratohen me 19 vota pro vendimet për dhënie titull “Qytetar Nderi” për.Z. Agim Idajet Shehu,z.Luis Mitat Çene, Z. Agron Asaf Galanxhi ( PAS VDEKJES) dhe për z. Banush Mezini dhe z.Petro Çerkezi .

Znj. Isaraj: Kalohet te pika e raportit të Drejtorisë Së Shërbimeve Komunitare.

Pyetjet rreth raportit dhe diskutimet.

Kalohet te pika 11.P/Vendim “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Institucioneve të APSH”.

Shprehet në emër të Komisionit Juridik znj. Orgesa Haska e cila sygjeron në emër të komisionit rregullimin e pikës 4 te neni 4 dhe të shtohet te baza ligjore Kodi i Procedurës Administrative.

Sqarohet nga Z. Ylli Muho arsyeja e kërkesës për një rregullore unike për të gjitha kopshtet.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro rregullorja e APSH-së.

Znj. Isaraj: Kalojmë të pika shtesë e cila ka të bëjë me investimin te taraca e gjimnazit “ Siri Shaplo”.

Sqaron për këshilltarët znj. Artiste Koko. Firma ka ndërhyrë pa marrë leje nga ne dhe si rrjedhojë nuk kemi asnjë detyrim për të paguar.Pra financimi i bashkisë do të jetë në zbatim të projektit që kërkon miratimin tuaj.

Hidhet në votë dhe miratohet me 18 vota pro pika shtesë:P/Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023” me qëllim financimin e projektit “ Hidroizilim dhe riparim ulluqesh ,gjimnazi “ Siri Shaplo”, Gjirokastër”.

Ngrihen disa probleme që kërkojnë zgjidhje nga ekzekutivi:

1. Çeshtja e trafikut në qytet nga z. Spartak Drasa.
2. Funksionimi I banjove publike nga z.nj. Manjola Shehaj.
3. Tabelat e rrugëve të shikohen nga Policia Bashkiake.

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj në orën 13:00

Sekretar I Këshillit  
Etleva Yzo

